

Data \_\_\_/\_\_\_/2023

## **PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

- **Objekti i procedurës:** “Blerja e paisjeve qe mundesojne transferimin e sistemeve operacionale dhe te dhenave meteorologjike nga zyra MET egzistuese ne aeroport ne zyren e re ne godinene operacionale si dhe shtimin e posteve te reja te punes per akomodimin e ketyre sistemeve”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 31680000-6 Pajisje elektrike; 31710000-6 Paisje elektronike; 30213300-8 Kompjuter desktop.
- **Vlera e fondit limit:** 14,166,666 (katërmëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

##### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

**Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë 40% e vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar dhe Katalog me të dhënat dhe karakteristikat teknike për pajisjet (zërin 2 Switch dhe zëri 18 Workstation) që do të ofrojë në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001: 2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- **ISO 27001:2017** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”

#### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

***ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

***ISO 27001:2017 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”** - është thelbesor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjencisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit European EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.*

*Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.*

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit përkatës për kryerjen e shërbimit në objektin e kërkuar, duhet të ketë në staf 5 (pese) punonjës të diplomuar në një nga degët Inxhinieri Elektrike/Elektronike/Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni etj. të certifikuar me njohuri si më poshtë:

- a) Te paktën 1 (një) Inxhinier, me Dëshmi Kualifikimi minimalisht Grupi IV mbi sigurimin teknik, për lidhjet elektrike të paisjeve.
- b) Te paktën 1 (një) Inxhinier të licencuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji për projektim të sistemeve:
  - Telefonisë, Internetit, CCTV etj.
- c) Te paktën 1 (një) Inxhinier të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose Ekuivalent)
- e) Te paktën 1 (një) Inxhinier të certifikuar për punime me fiber optike.
- f) Te paktën 1 (një) Inxhinier të certifikuar për Rrjetë Networking (CCNA ose ekuivalent)

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor,**

**dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Diploma;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Gusht 2023 – Tetor 2023;

#### **Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albcontrol sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Në mënyrë që të zgjerojë konkurrencën dhe për të moslimituar operatorët ekonomik, AK ka kërkuar 5 inxhinierë të cilët mund të jenë të profiëve ekuivalente elektronik /telekomunikacion/informatik/kompjuterik. Referuar aftësive dhe kompetencave që këta persona zotërojnë sipas profesionit do të angazhohen drejtpërdrejtë në mbikqyrjen dhe drejtimin e proceseve të instalimit të sistemeve të AK.*

*Referuar kriterit të mësipërm për realizimin me sukses dhe brenda afateve është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik e një numri minimal prej 5 të punësuarisht duke marrë në konsideratë nevojën për inxhinierë të specializuar për drejtimin e proceseve komplekse që përfshijnë punimet për instalimin të paisjeve për rrjetin IP, rrjetin Lan etj. Integrimin e të gjithë rrjetit në një sallë të vetme monitorimi të qëndëruar etj dhe nevojën për të realizuar e sukses të gjithë kontratën brenda afatit.*

*Për të garantuar eksperiencën e stafit të operatorit ekonomik pasi kemi të bëjmë me një procedurë që për Albcontrol sh.a është shumë e rëndësishme është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik për të paktën 3-muaj që është dhe periudha minimale e parashikuar në Kodin e Punës si periudhë prove për një punonjës.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë liçensat profesionale të vlefshme nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise të kategorisë.

- a) NS13-A Impiante dhe Linja Telefonie dhe Telekomunikacioni
- b) NS14-A Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore pasi sigurimi me suksese i shërbimit ka impakt në punën e drejtëpërdrejtë të AK, disponimi i këtyre liçensave nga operatorët ekonomikë është një kërkesë e domosdoshme dhe në proporcion me objektin e prokurimit.*

*Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

## **NJESIA E PROKURIMIT**

### **I. Argumentimi i Specifikimeve teknike**

*Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e këktij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

Në mbështetje të Nenit 158, pika 3, shkronja “a” të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); Nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregulloreve të prokurimit publik” (i ndryshuar); në Nenin 27, pika 2, shkronjat “a” e “n” të Statutit të Shoqërisë “ALBCONTROL” SHA; në Programin e Zhvillimit Ekonomik të vitit 2021, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës e Energjisë dhe Ministria e Financave e Ekonomisë me shkresën Nr.24199/1 datë 18.01.2021,

Në bazë të nevojave të Autoritetit Kontraktor për “Blerja e paisjeve që mundesojnë transferimin e sistemeve operacionale dhe të dhenave meteorologjike nga zyra MET egzistuese në aeroport në zyren e re në godinën operacionale si dhe shtimin e posteve të reja të punës për akomodimin e këtyre sistemeve”, struktura e specializuar përcaktoi specifikimet teknike që do të jenë si më poshtë:

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

“Blerja e paisjeve qe mundesojne transferimin e sistemeve operacionale dhe te dhenave meteorologjike nga zyra MET egzistuese ne aeroport ne zyren e re ne godinene operacionale si dhe shtimin e posteve te reja te punes per akomodimin e ketyre sistemeve”.

## PËRMBAJTJA

Regjistrimi i Ndryshimeve të Dokumentit.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
PËRMBAJTJA.....	8
Hyrje.....	9
Konfidencialiteti .....	9
1. Të Përgjithëshme .....	10
<b>1.1 Gama e Furnizimit</b> .....	10
2. Kërkesat teknike për sistemin KVM me IP i MET Office.....	11
<b>2.1. Kërkesa të përgjithëshme për instalimin</b> .....	11
Shtojca A: Lista e paisjeve dhe shërbimeve .....	13



## **Hyrje**

Sherbimet meteorologjike jane nje pjese e rendesishme e sherbimeve te ofruara nga Albcontrol ne zonen e aeroportit.

Meqenese zyra e sherbimeve MET do te spostohet tek godina teknologjike jane pergatirur specifikimet teknike si ne vijim per te mundesuar transferimin pa ndikuar ne cilesine e sherbimit ne zbatim te Urdherit te Brendshem nr. 237/1 date 06.11.2023.

## **Konfidencialiteti**

I gjithe Informacioni i marrë nËpËrmjet kËsaj procedure ËshtË pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta pËrdorin apo shpËrndajnË tek tË tretË pËrvecse pËr nevojat e pËrmbushjes dhe plotËsimit tË ofertËs sË tyre.

Po kËshtu oferta e dorËzuar nË Albcontrol do tË trajtohet si konfidenciale dhe nuk do tË shpËrndahet tek tË tretË jashtË Albcontrol-it.

## **1. Të Përgjithëshme**

Zhvendosja ne zyren e re te këtij sistemi duhet të sigurojë vijueshmërinë e punës, rritjen e performancës së tij, ruajtjen e nivelit të SAFETY në Albcontrol dhe plotësimin e standarteve të ICAO-s. Kjo mirëmbajtje do të mbulojë pjesën software dhe hardware të këtij sistemi. Per te permiresuar kushtet ne postet e punes te sistemit MET controli i PC do te kryhet me ane te lidhjeve KVM ne IP.

Bazuar në sa u përmenden më lart si dhe në rëndësinë e shërbimit të Albcontrol-it si kompani në këtë mirëmbajtje do të reflektohen hapat për sa më poshtë:

1. Furnizimin e pajisjeve te nevojeshme KVM dhe instalimi i tyre ne postet e punes ne zyren e re
2. Kontroll dhe vlerësim i funksionimit te posteve pas instalimit

### **1.1 Gama e Furnizimit**

**Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet si vijon**

#### **A- Sistemet MET**

- a. Furnizimi i sistemit te KVM me pajisje kontrolli qendrore
- b. Furnizim me switch Layer 3 per rrjetin IP gigabitethernet
- c. Furnizimi me fiber optike single mode dhe Terminimi i lidhjeve te fibres ne sallen e pajisjeve dhe ne zyren e re MET

<b>2. Kërkesat teknike për sistemin KVM me IP i MET Office</b>	
<b>2.1. Kërkesa të përgjithëshme për instalimin</b>	
<b>Nr i specifikimit</b>	<b>Specifikimi</b>
<b>2.1.1</b>	<p>Kontraktuesi duhet të marrë persiper furnizimi e paisjeve si me poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cifte KVM per kontrollin remote te PC</li> <li>2. Paisje Manaxhimi dhe kontrolli i KVM</li> <li>3. Switch Layer 3 GigabitEthernet</li> <li>4. Terminim i lidhejve te fibres midis PC dhe postit te punes</li> <li>5. Rack per vendosjen e workstation tek salla e paisjeve</li> <li>6. Monitor 65” me porta HDMI dhe DP bashke me kit per instalim ne mur</li> <li>7. Monitor 32” me porta HDMI dhe DP bashke me kit per instalim ne mur</li> </ol>
<b>2.1.2</b>	<p>Specifikat e lidhjeve te cifteve KVM do te jene si me poste:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Seti i zgjatuesve KVM duhet të plotësojë kërkesat minimale te meposhteme             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Lidhja me bazën IP.</li> <li>b. Transmetimi ne linje Fiber Optike.</li> <li>c. Pershtatshmeria me sisteme operative te ndryshme (p.sh. Windows, Linux, ecc.)</li> <li>d. Nderfaqesim USB përshtirjen e tastierës dhe mausit (në rast të workstation me tastierë dhe maus PS / 2, do të përdoren përshtatës të veçantë).</li> <li>e. Shtrirja e audios</li> <li>f. Shtrirja seriale (port RS232)</li> <li>g. Operacionet Hot-plug dhe hot-swap, gjatë veprimtarisë së workstation</li> <li>h. Akses lokale në workstation</li> </ol> </li> <li>2. Teknologjia e zgjatuesve KVM duhet të jete ne gjendje te siguroje konfigurim nje per nje ose konfigurim nje ne disa (multicast).</li> <li>3. Teknologjia e zgjerimit KVM duhet të lejojë të kaloje lehtë lidhjen midis transmetuesit dhe marresit, duke zbatuar në këtë mënyrë një KVM switch te matricës</li> <li>4. Seti zgjerimit KVM duhet të lejoje akses ne workstation (KVM) duke perdorur nje port menaxhuese te dedikuar</li> <li>5. Transmetuesi zgjerues KVM duhet të lejoje perdorimin e dy rrugeve te ndyshme (lidhje te teperta) per te komunikuar me moduln e marresit, me qellim arritjen e redondances</li> <li>6. Zgjeruesit KVM duhet të menaxhohen dhe monitorohen nga nje njesi kontrolli qendrore. Njesia qendrore e kontrollit duhet të lejoje të menaxhoje 30 % me shume se sa ka nevojte workstation aktual.</li> <li>7. Çdo workstation duhet të funksionojte nepermjet përdorimit te një zgjatuesi te dedikuar KVM mbi teknologjinë IP. Seti do të përbëhet nga dy njësi: transmetuesit dhe pranuesit, të lidhura nga një rrjet specifik dhe i dedikuar GBit bazuar ne teknologjine IP</li> <li>8. Switchet Layer 3, KVM transmetuese dhe paisja manaxhuese e KVM-ve do të instalohen ne sallen e paisjeve (dataroom)</li> <li>9. KVM-te marresa do të instalohen ne zyren e re te MET</li> </ol>

	<p>10. Përveç portave për ekranet çiftet KVM-te duhet të kenë edhe porta USB për lidhjen e mouse, keyboard dhe audio</p> <p>11. Komunikimi midis pajisjeve dhe switchi-t do të bëhet me atë të fibrit optik</p> <p>12. Në postet të cilat kanë me shumë se një workstation duhet të bëhet i mundur përdorimi i një mouse dhe tastiere për të gjithë workstation. Kjo gjë mund të mundësohet ose nga kontrolleri qendror ose me KVM ekstra për mouse dhe tastiere</p>
<p><b>2.1.3</b></p>	<p>Specifikimet e rrjetit IP</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një rrjet i ri dhe i dedikuar duhet të ofrohet për të lidhur njësitet transmetuese dhe marrese. Rrjeti duhet të jetë i fuqishëm dhe me tepricë, me porte 1-GB dhe 10-GB uplink.</li> <li>2. Switch-i duhet të ketë minimumi 24 porta 1-GB dhe 4 porta 10-GB</li> <li>3. Portat duhet të jenë me SFP për mundësi lidhje të sfp optike dhe bakri</li> <li>4. Rrjeti LAN duhet të jetë me madhësi të saktë për të garantuar gjerësinë e bandës së nevojshme për menaxhimin real-time të të gjithë trafikut të videove nga workstation</li> <li>5. Njësitet e transmetuesit dhe marresit duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë në pajisjet komutuese në mënyrë që gabimi i një pajisjeje të vetme të rrjetit nuk duhet të ndikojë në të gjithë shërbimin.</li> <li>6. Switches në Layer 3 duhet të jenë të ndashme dhe të kenë karakteristikat minimale të mëposhtme:       <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Performanca e kapacitetit Switch &gt;150 Gbps.</li> <li>b. Portat e switchit të jenë SFP</li> <li>c. Të jenë stackable</li> <li>d. Të mbështesin minimumi standartet e mëposhtme           <ol style="list-style-type: none"> <li>i. IEEE 802.1D Spanning Tree Protocol</li> <li>ii. IEEE 802.1w Rapid Spanning Tree Protocol</li> <li>iii. IEEE 802.1s Multiple Spanning Trees Protocol</li> <li>iv. IEEE 802.1Q VLAN Tagging</li> <li>v. IEEE 802.3x Flow Control</li> <li>vi. IEEE 802.3ad Link Aggregation</li> <li>vii. IEEE 802.1X Port Authentication</li> <li>viii. RFC 1112 IGMPv1</li> <li>ix. RFC1157 SNMP</li> <li>x. RFC 2236 IGMPv2</li> <li>xi. RFC3315 DHCP for IPv6</li> <li>xii. RFC 3410 SNMPv3</li> <li>xiii. IPv6 routing</li> </ol> </li> <li>e. Redundant power supply</li> </ol> </li> </ol>
<p><b>2.1.4</b></p>	<p>Specifikimet e fibrit optik</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjatesia e kabllit 200 m</li> <li>2. Kapaciteti 24 fije single mode</li> <li>3. Terminimi do të kryhet në sallën e pajisjeve dhe zyrene e re të MET në porta SC</li> <li>4. Terminimi do të kryhet në dy patch panele me 24 porta       <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Një patch panel do të vendoset në data room në një nga Rack-et</li> </ol> </li> </ol>

	b. Nje patch panel do te vendoset ne zyren e re MET
<b>2.1.5</b>	Furnizuesi/prodhuesi i sistemit KVM duhet te demonstroje me evidenca te pakten nje projekt te implementuar ne nje Air Navigation Service Provider per sistemet Operacionale
<b>2.1.6</b>	Furnizuesi duhet te paraqese evidence ne pjesen Software te sistemit KVM per Safety Assurance Level. E cila duhet te jete compatible me kerkesat e Nivelit 4

Shtojca A: Lista e paisjeve dhe shërbimeve

Nr .	Pershkrimi pjeseve/sherbimeve	Njesia	Sasia	Koha e kryerjes
<b>A</b>	<b>Instaimi i Sistemit KVM</b>			
1	Paisje Manaxhimi e KVM me IP me dalje sfp fiber optike dhe baker	cope	2	
2	Switch Layer 3 me 24 porta SFP	cope	2	
3	SFP me nje fije fiber optike single mode me konektor LC	cope	40	
4	SFP me porte baker	cope	6	
5	Patch fiber optike single mode me konektor SC-LC me gjatesi 2m	cope	30	
6	Patch fiber optike single mode me konektor SC-LC me gjatesi 3m	cope	30	
7	Cift KVM (transmetues dhe marres) me dalje VGA dhe porte komunikimi me fiber optike	cope	6	
8	Cift KVM (tramnsmetuer dhe marres) me nje dalje DP dhe porte komunikimi me fiber optike	cope	10	
9	Cift KVM (tramnsmetues dhe marres) me dy dalje DP dhe porte komunikimi me fiber optike	cope	4	
10	Display 65” me mundesi per “split screen”, me min 4 hydrje HDMI ose DP per lidhje me KVM	cope	1	
11	Kabell HDMI ose DP me gjatesi 10 m	cope	5	
12	Garanci nga prodhuesi per ciftet KVM dhe paisjen menaxhuese	vit	1	
13	Konvertues HDMI ne DP	cope	5	
14	Rack 42U 600mm Wide x 1060mm Deep Enclosure APC	cope	2	
15	Rack Shelf	cope	10	
16	Prize per Rack	cope	4	
17	Fan per Rack	cope	2	

18	Pc workstation 16Gb ram 512 SSd Intel core I7 + Monitor 24"	cope	3	
19	Suport metalike ose plastike per vendosjen e nje patch paneli te fibres optike nen tavolinat e zyres MET	cope	1	
20	Suport metalike ose plastike per vendosjen e 15 KVM marres nen 2 tavolinat e zyres MET	cope	2	